


04.03.2016



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR VLORE

Nr Rregj.378  
Date regj 28.03.2014

Nrt 639 (61-2014-4141)  
Data 18.12.2014

**V E N D I M**  
**"Ne Emer te Republikes"**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore, e perbere nga:

GJYQTAR - Kryesues  
GJYQTARE – Antar  
GJYQTARE – Antar

Arqile Basho  
Anastasi Shehu  
Laurent Fuçia

Asistuar prej sekretares Luljeta Kollombo,  
Me pjesmarrjen e prokurorit Klodian Braho,  
Ne gjykate, sot ne date 18.12.2014, ne seance gjyqesore publike per shqyrtimin e ceshtjes penale ne ngarkim te:

**TE PANDEHUR:** 1-**Hasan Meta**, i biri i Faik dhe Barije, dt/lindja 7.12.1954, lindur dhe banues ne Vlore, Lagje "1 Maji", i martuar, me arsim te mesem, me shtetesi Shqiptare, i hetuar dhe gjykuar nen masen e sigurimit "detyrim per tu paraqitur ne policine gjyqesore".

2-**Amat (Hamat) Meta**, i biri i Faikut dhe Barijes, dt/lindja 10.07.1960, lindur dhe banues ne Vlore, Lagje "1 Maji", i martuar, me arsim te mesem, me shtetesi Shqiptare, i hetuar dhe gjykuar nen masen e sigurimit "detyrim per tu paraqitur ne policine gjyqesore"..

-**Te perfaqesuar** ne gjykim nga av. Zenun Hadermataj, Dhoma e Avokatisë Fier, - i zgjedhur me Prokuren (Revokim procure) Nr 389 Rep, Nr 340 Kol, dt 12.06.2014.

**TE AKUZUAR:** Per kryerjen e veprave penale te "Fallsifikimit te dokumentave" dhe "Pastrim i produkteve te vepres penale".

**Parashikuar:** Perkatesisht nga nenet 186/2 dhe 287/1, pika "dh" e K.Penal, sipas permbajtjes se kesaj dispozite para ndryshimeve te bera me ligjin nr.23/2012.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te kerkeses palet kerkuan:

**Prokurori:-**

1. Deklarimin fajtor te te pandehurit Amat Meta per kryerjen e vepres penale "**Pastrimi i produkteve te vepres penale**" te parashikuar nga neni 287/1, pika (dh) te K.Penal, sipas permbajtjes se saj para ndryshimeve te ligjit nr.23/2012 dhe denimin e tij ne baze te kesaj dispozite me 6 (gjashte) vjet burgim.
2. Deklarimin fajtor te te pandehurit Amat Meta per kryerjen e vepres penale "**falsifikimi i dokumentave**", me shume se nje here, te parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal dhe denimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.
3. Ne baze te nenit 55 te K.Penal, i pandehuri Amat Meta te denohet perfundimisht me 7 (shtate) vjet burgim.
4. Ne baze te nenit 406 te K.Pr.Penale i kerkojme Gjykates qe te ulet 1/3 e mases se denimit me burgim.
  
5. Deklarimin fajtor te te pandehurit Hasan Meta per kryerjen e vepres penale "**Pastrimi i produkteve te vepres penale**" te parashikuar nga neni 287/1, pika (dh) te K.Penal, sipas permbajtjes se saj para ndryshimeve te ligjit nr.23/2012 dhe denimin e tij ne baze te kesaj dispozite me 6 (gjashte) vjet burgim.
6. Deklarimin fajtor te te pandehurit Hasan Meta per kryerjen e vepres penale "**Falsifikimi i dokumentave**", me shume se nje here, te parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal dhe denimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.
7. Ne baze te nenit 55 te K.Penal, i pandehuri Hasan Meta te denohet perfundimisht me 7 (shtate) vjet burgim.
8. Ne baze te nenit 406 te K.Pr.Penale i kerkojme Gjykates qe te ulet 1/3 e mases se denimit me burgim.
  
9. Ne baze te nenit 391/1 te K.Pr.Penale, te deklarohen si te falsifikuara, duke urdheruar fshirjen dhe zhdukjen e tyre, dokumentat e meposhtme;
  - a. Shkrese nr.385/1 prot dt.25.10.2006 e Arkivit Shteteror Vendor Vlore;

- b. Leje meremetimi nr.124 date 12.06.1989, ne emer Hamat Meta;
  - c. Shkrese nr.384/1 prot dt.25.10.2006 e Arkivit Shteteror Vendor Vlore;
  - d. Leje meremetimi nr.1'13 date 04.02.1989, ne emer Hasan Meta;
  - e. Certificate pronesie e pasurise nr.27/4/7, zona kadastrale nr.8602, ne emer te Hamat Meta, kartela e kesaj pasurie, harta treguese e rregjistrimit;
  - f. Certificate pronesie e pasurise nr.27/4/8, zona kadastrale nr.8602, ne emer te Hasan Meta, kartela e kesaj pasurie, harta treguese e rregjistrimit;
10. Ne baze te nenit 36/b te Kodit Penal, te konfiskohen dhe te kalojne ne favor te shtetit dhe te fshihen nga rregjistri i Z.Rr.P.P Vlore, produktet e vepres penale "**falsifikimi i dokumentave**", te cilat jane nen masen e sigurimit te sekuestros preventive, dhe konkretisht;
- a. Pasuria me nr.27/4/7, zona kadastrale nr.8602, volumi 28, faqe 77, me siperfaqe 328.6 m<sup>2</sup> truall, ne pronesi te te pandehurit Amat (Hamat) Meta;
  - b. Pasuria me nr.27/4/8, zona kadastrale nr.8602, volumi 28, faqe 78, me siperfaqe 328.6 m<sup>2</sup> truall, ne pronesi te te pandehurit Hasan Meta;
11. Ne baze te nenit 36/b te Kodit Penal, gjithashtu kerkojme qe te konfiskohen dhe te kalojne ne favor te shtetit, produktet e vepres penale "**pastrimi i produkteve te vepres penale**", te cilat jane nen masen e sigurimit te sekuestros preventive, pjesa takuese e ndertimit e te pandehurve sipas kontrates se lidhur me shoqerite ndertuese nr.2639 Rep dhe nr.890/1 Kol, date 09.07.2012, dhe konkretisht;
- a. Garazhet ne katin (-2), dy cope, te shenuar ne projekt me nr.1 dhe nr.2;
  - b. Garazhet ne katin (-1), 3 cope, te shenuar ne projekt me nr. 10, 11,14;
  - c. Dyqani ne katin (1) me nr.10, me siperfaqe 43.8 m<sup>2</sup> dhe dyqani ne katin (I) me nr.15, me siperfaqe 43.4 m<sup>2</sup>;
  - d. Dyqani ne katin (2) me nr.8, me siperfaqe 38.1 m<sup>2</sup> dhe nr.14, me siperfaqe 52.7 m<sup>2</sup>;
  - e. Dyqan ne katin (3) te shenuar ne projekt me nr.14, me siperfaqe 100 m<sup>2</sup>;

- f. Apartamentet ne katin (4) te shenuar ne projekt me nr.5-siperfaqe 8'1.2 m2, nr.7-siperfaqe 8'1.2 m2, me nr.2-siperfaqe 125 m2;
  - g. Apartament ne katin (5), te shenuar ne projekt me nr.2-siperfaqe 125 m2,
  - h. Apartamentet ne katin (6) te shenuar ne projekt me nr.4-siperfaqe 81.2 m2, me nr.'10-siperfaqe 132.8 m2;
  - i. Apartament ne katin (8), te shenuar me nr.3-siperfaqe 124.5 m2;
  - j. Apartamentet ne katin (10), te shenuar me nr.3-siperfaqe 124.5 m2, me nr.6-siperfaqe 81.2 m2;
  - k. Apartament ne katin (11), te shenuar me nr.6-siperfaqe 81.2 m2.
12. Ne haze te nenit 190/1, germa (g) te K.Pr.Penale, lidhur me dokumentet e tjera te sekuestruara, dokumentacioni i dosjeve te pasurive nr.27/4/7 dhe nr.27/4/7, zona kadastrale nr.8602, te pershkruar ne proces verbalin per sekuestrimin e dokumentave date 02.07.2013, ti kthehen Z.Rr.P.P Vlore, sipas proces verbalit perkates te sekuestrimit.
73. Shpenzimet proceduriale ne hetim, ne masen 51.000 leke, si dhe ato gjyqesore, t'ju ngarkohen te pandehurve.

**Mbrojtja:** - Deklarimin te pafajshem te te pandehurve Amat (Hamat) Meta dhe Hasan Meta per kryerjen e vepres penale te fallsifikimit te dokumentave dhe pastrimit te produkteve te vepres penale qe rrjedhin nga vepra penale te parashikuara nga nenet 186/2 dhe 278/1 te Kodit Penal.

**Te pandehurit:** - ne mungese.

Gjykata pasi degjoi palet, shqyrtoi provat e parashtruara si dhe ceshtjen ne teresi,

## V E R E N

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore ka parashtruar kerkesen per gjykimin e Procedimit Penal Nr 634/388, te vitit 2013, ne ngarkim te te pandehurve Hasan Meta dhe Amat (Hamat) Meta, te akuzuar per kryerjen e veprave penale te "Fallsifikimi i dokumentave" dhe "Pastrim i produkteve te vepres penale", te parashikuara perkatesisht nga nenet 186/2 dhe 287/1, pika "dh" te K.Penal.

**Nga shqyrtimi gjyqesor i kerkeses rezultoi se :**

Prokuroria ka nisur dhe perfunduar hetimin e Proçedimit Penal Nr.634 (388), dt 06.06.2013, ne ngarkim te te pandehurve Hasan Meta dhe Amat (Hamat) Meta, te akuzuar per vepren penale te "Fallsifikimi i dokumentave" dhe "Pastrim i produkteve te vepres penale", te parashikuara perkatesisht nga nenet 186/2 dhe 287/1, pika "dh" te K.Penal (sipas gjendjes se dispozites para ndryshimeve me Ligjin Nr 23/2012) dhe ka parashtruar kerkesen per gjykimin e ketij procedimi penal ne gjykate ne daten 28.03.2014.

**Nga shqyrtimi I provave qe lidhen me kerkesen rezulton se:**

Ne daten 06.06.2013, Prokuroria e Rr.Gj.Vlore ka rregjistruar Procedimin Penal Nr 634, viti 2013, per veprat penale te "fallsifikimit te dokumentave" parashikuar nga neni 186 te K.Penal dhe "Shperdorimit te detyres" parashikuar nga neni 248 te K.Penal.

Me kryerjen e veprimeve te para hetimore ka rezultuar se te pandehurit Amat Meta dhe Hasan Meta kane fallsifikuar dokumentacionin per perfitimin e pronesise mbi nje siperfaqe trualli dhe e kane kontraktuar kete siperfaqe me nje subject ndertues per ndertim objekti.

Ne keto rrethana ne daten -.07.2013, me urdherin e Prokurorit, eshte urdheruar rregjistrimi I personave nen hetim Hasan Meta dhe Amat (Hamat) Meta, ne rregjistrin e veprave penale per Procedimin penal Nr 634, viti 2013.

Me kryerjen e veprimeve hetimore rezultojne te provuara rrethanat sipas te cilave te pandehurit kane vene ne dispozicion truallin per ndertimin e objektit, marreveshjet e kryera, dokumentacioni i krijuar per marrjen (miratimin) e sheshit te ndertimit dhe te lejes se ndertimit, dokumentacioni i rregullt i pronesise dhe dokumentacioni i fallsifikuar si dhe veprimtarine e ligjshme apo te kundraligjshme ne kete process hetimi.

Konkretisht:

I.- Ne ZVRPP Vlore, ne daten 24.10.2007 eshte rregjistruar pasuria e paluajtshme me Nr 27/4/7, Zoana Kadastrale 8602, Volumi 28, faqe 77, me siperfaqe 328.6 m2 truall, ne pronesi te te pandehurit Amat (Hamat) Meta. Rregjistrimi I kesaj pasurie eshte kryer mbi bazen e aplikimit dhe te kerkeses per rregjistrim te kryer nga I pandehuri nAmat Meta, dt 24.10.2007.

Ne dokumentacionin e depozituar I pandehuri ka paraqitur shkresen me Nr 385/1 prot, dt 25.10.2006 te Arkivit Shteteror Vendor Vlore, bashkelidhur nje document I titulluar "Leje Meremetimi" Nr 124 Regjistri te Lejes dt 12.06.1089 ne permbajtje te se ciles eshte lejuar qytetari Amat (Hamat) Meta te ndertoje nje magazine per tregetimin e peshkut sipas projektit te miratuar ne Lagjen "Skele", Rruga "10 Korriku" Vlore. Dokumenti eshte kopje e njesuar

me vulen e arkivit dhe sipas permbajtjes se tij eshte leshuar nga Zyra e urbanistikes e Komiteit Ekzekutiv te Keshillit Popullor te Qytetit Vlore.

Me kryerjen e veprimeve hetimore per verifikimin e vertetesise se ketij dokumenti rezulton e provuar se I pandehuri Amat Meta ka paraqitur kerkese ne daten 16.10.2006, ne te cilen ka kerkuar dokumentin e lejes se ndertimit te nje lokali ne vitin 1989. Kerkesa ne fjale eshte protokolluar ne Arkivin Shteteror Vendor Vlore, ne numerin e protokollit 385, date 16.10.2006.

Me shkresen me nr.385/1 prot dt.06.02.2007 Arkivi Shteteror Vendor Vlore i ka kthyer pergjigje te pandehurit Amat Meta qe nga kerkimet e kryera ne fondin e Komitetit Ekzekutiv te K.P te Qytetit Vlore per vitin 1989, ka rezultuar se nuk ka leje ndertimi ne emer te Amat (Hamat) Meta.

Mbi veprimet hetimore te verifikimit te faktit ne lidhje me ekzistencen e ketij dokumenti, jane kerkuar te dhena nga Arkivi Shteteror Vendor Vlore dhe me shkresen me nr. 193/6 prot dt. 15.07.2013 eshte konfirmuar fakti qe nga kerkimet e kryera ne kete Institution nuk rezulton se ka ndonje dokument, leje meremetimi me nr.125 date 12.06.1989. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera ne Arkiv dhe ne protokollin e ketij Insitucioni, nuk rezulton qe te ndodhet shkresa me nr.385/1 prot dt.25.10.2006, apo dokumenta te tjera qe te konfirmojne vertetesine e kesaj shkrese.

Ne keto rrethana, konkludohet se dokumenti shkrese me nr.385/1 prot dt.25.10.2006 e Arkivit Shteteror Vendor Vlore, bashkelidhur se ciles ndodhet nje dokument, e titulluar "Leje Meremetimi", nr. 124 i rregjistrit te lejes date 12.06.1989, i perdorur nga i pandehuri Amat Meta per rregjistrimin e pasurise me nr.27/4/7, zona kadastrale nr.8602, volumi 28, faqe 77, me siperfaqe 328.6 m<sup>2</sup> truall, eshte dokument i falsifikuar dhe pasuria ne fjale rezulton se eshte produkt i vepres penale te falsifikimit dhe perdorimit te ketij dokumenti.

**II.** - Ne daten 24.07.2007 eshte rregjistruar pasuria e paluajtshme me nr.27/4/8, zona kadastrale nr.8602, volumi 28, faqe 78, me siperfaqe 328.6 m<sup>2</sup> truall, ne pronesi te te pandehurit Hasan Meta.

Rregjistrimi i kesaj pasurie eshte kryer mbi bazen e aplikimit dhe te kerkeses per rregjistrim te kryer nga i pandehuri Hasan Meta, te dates 24.10.2007. Ne dokumentacionin e depozituar i pandehuri Hasan Meta ka paraqitur shkresen me nr.384/1 prot dt.25.10.2006 e Arkivit Shteteror Vendor Vlore, bashkelidhur se ciles ndodhet nje dokument, e titulluar "Leje Meremetimi", nr.113 i rregjistrit te lejes date 04.02.1989, me ane te se ciles eshte lejuar qytetari Hasan Meta qe ne lagjen Skele, prane Portit, te ndertoje nje magazine nje lokal per sherbime te ushqimit social sipas projektit te aprovuar. Dokumenti eshte fotokopje e njesuar me vulen e arkivit, sipas permbajtjes se tij eshte leshuar nga Zyra e Urbanistikes, Komiteti Ekzekutiv K.P. Qytetit Vlore.

Me kryerjen e veprimeve hetimore per verifikimin e vertetesise se ketij dokumenti rezulton e provuar se ne Arkivin Shteteror Vendor Vlore i pandehuri Hasan Meta ka paraqitur nje kerkese ne daten 16.10.2006, ne te cilen ka kerkuar dokumentin e lejes se ndertimit te nje lokali ne vitin 1989. Kerkesa ne fjale eshte protokolluar ne Arkivin Shteteror Vendor Vlore, ne numerin e protokollit 384, date **16.10.2006**.

Me shkresen me nr.384/1 prot dt.06.02.2007 Arkivi Shteteror Vendor Vlore i ka kthyer pergjigje te pandehurit Hasan Meta qe nga kerkimet e kryera ne fondin e Komitetit Ekzekutiv te K.P te Qytetit Vlore per vitin 1989, ka rezultuar se nuk ka leje ndertimi ne emer te Hasan Meta.

Mbi veprimet hetimore te verifikimit te faktit ne lidhje me ekzistencen e ketij dokumenti, jane kerkuar te dhena nga Arkivi Shteteror Vendor Vlore dhe me shkresen me nr.193/7 prot dt.15.07.2013 eshte konfirmuar fakti qe nga kerkimet e kryera ne kete Institucion nuk rezulton se ka ndonje dokument, leje meremetimi me nr.113 date 04.02.1989. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera ne Arkiv dhe ne protokollin e ketij Insitucioni, nuk rezulton qe te ndodhet shkresa me nr.384/1 prot dt.25.10.2006, apo dokumenta te tjera qe te konfirmojne vertetesine e kesaj shkrese.

Ne keto rrethana, dokumenti shkrese me nr.384/1 prot dt.25.10.2006 e Arkivit Shteteror Vendor Vlore, bashkelidhur se ciles ndodhet nje dokument, e titulluar "Leje Meremetimi", nr.113 i rregjistrimit te lejes date 04.02.1989, i perdorur nga i pandehuri Hasan Meta per rregjistrimin e pasurise me nr.27/4/8, zona kadastrale nr.8602, volumi 28, faqe 78, me siperfaqe 328.6 m<sup>2</sup> truall, eshte dokument i falsifikuar dhe pasuria ne fjale rezulton se eshte produkt i vepres penale te falsifikimit dhe perdorimit te ketij dokumenti.

**III.** - Dokumentat e pershkruar me siper, nr.384/1 prot dt.25.10.2006 e Arkivit Shteteror Vendor Vlore, bashkelidhur "Leje Meremetimi", nr.113 i rregjistrimit te lejes date 04.02.1989, i perdorur nga i pandehuri Hasan Meta, si dhe shkresa me nr.385/1 prot dt.25.10.2006 e Arkivit Shteteror Vendor Vlore, bashkelidhur "Leje Meremetimi", nr.124 i rregjistrimit te lejes date 12.06.1989, i perdorur nga i pandehuri Amat Meta, jane dokumente te falsifikuara pasi kane ne permbajtje te tyre rrethana te rreme dhe te paverteta.

Nga verifikimet e kryera ne Arkivin Shteteror Vendor Vlore nuk rezulton qe te ekzistojne "Leje Meremetimi", nr.113 i rregjistrimit te lejes date 04.02.1989 apo "Leje Meremetimi", nr.124 i rregjistrimit te lejes date 12.06.1989.

Perkundrazi, te pandehurit jane informuar me shkresat nr.385/1 prot dt.06.02.2007 dhe nr.384/1 prot dt.**06.02.2007** te Arkivi Shteteror Vendor Vlore se nuk ekzistojne ne kete arkive leje ndertimi ne favor te tyre.

Nderkohe, kërkesa për regjistrimin e dy pasurive dhe dokumentacioni përkatës, nga të dy të pandehurit është depozituar në Z.Rr.P.P Vlorë në datën **24.10.2007**, konkretisht pas përgjigjes negative të dy shkresave të mesipërme.

Shkresat e Arkivit Shtetëror Vendor Vlorë me përmbajtje të falsifikuara, janë të nënshkruara në emër të shtetasit Sokol Kucaj në cilësinë e "Drejtorit, i ngarkuari i posaçëm", si dhe përmbajnë vulën e njome të Arkivit.

Me Aktin e Ekspertimit tekniko grafik të vules dhe nënshkrimit të ndodhur në këto dokumente, Nr.2827, datë 12.03.2014 të Drejtorisë së Policisë Shkencore ka rezultuar se vula e ndodhur në këto dokumente i përket Arkivit Shtetëror Vendor, ndërsa **nënshkrimet në emër të Sokol Kucaj janë të falsifikuara me metodën e imitimit dhe nuk janë nënshkrimet e këtij shtetasi.**

Në këto rrethana konkludohet se përveçse dokumentat janë të falsifikuara në përmbajtjen e tyre, janë të falsifikuara edhe nga ana teknike, duke imituar nënshkrimin e shtetasit të mesipërme.

Mbi bazën e këtyre dokumentave të falsifikuara i pandehuri Amat Meta është pajisur me Certifikatën e Pronësive për pasurinë me nr.27/4/7 zona kadastrale nr.8602, leshuar me datë 24.10.2007, kartelen e kesaj pasurie dhe hartën treguese, ndërsa i pandehuri Hasan Meta është pajisur me Certifikatën e Pronësive për pasurinë me nr.27/4/8, zona kadastrale nr.8602, leshuar me datë 24.10.2007, kartelen e kesaj pasurie dhe hartën treguese. Këto dokumente, pavarësisht se janë leshuar nga Z.Rr.P.P Vlorë, kanë në përmbajtje të tyre rrethana të rreme, pasi janë dokumenta të prejardhura nga dokumenta të falsifikuara dhe të pandehurit Amat Meta dhe Hasan Meta kanë teresisht dijeni se në të vërtetë ata nuk janë pronarë të ligjshëm të dy pasurive të mesipërme, por i kanë regjistruar këto pasuri mbi bazën e dokumentave të falsifikuara.

IV. - Në datën 03.10.2011 të pandehurit Amat (Hamat) Meta dhe Hasan Meta kanë lidhur kontratën e sipërmarrjes me akt noterial, me nr.3451 Rep dhe nr.1083/1 Kol, me shoqëritë sipërmarrëse "Hanxhari" sh.p.k dhe "Breshani" sh.p.k.

Në bazë të kesaj kontrate, shtetasit Amat Meta dhe Hasan Meta duke u paraqitur si pronarë të pasurive të paluajtshme me nr.27/4/7 dhe 24/4/8 të zonës kadastrale nr.8602, kanë rënë dakort për ndërtimin e një objekti me 13 kate në pasuritë e mesipërme, që do të ndërtohet me shpenzimet e



shoqerive ndertuese te mesiperme. Sipas kesaj kontrate te pandehurit Amat Meta dhe Hasan Meta do te perfitojne 30% te siperfaqes se ndertimit te objektit qe do te ndertohej.

Ne momentin e lidhjes se kesaj kontrate i pandehuri Amat Meta ka perdorur certifikaten e pronesise per pasurine me nr.27/4/7, kartelen dhe harten treguese te kesaj pasurie. Gjithashtu, i pandehuri Hasan Meta ka perdorur certifikaten e pronesise per pasurine me nr.27/4/8, kartelen dhe harten treguese te kesaj pasurie.

Rezulton e provuar se Subjekti ndertues "Hanxhari" shpk, me administrator Fatmir Hanxhari, ka lidhur **Kontrate Sipermarrje me Nr 3451 ,Nr 1083/2 kol, dt. 03/10/2011, me shtetasit Hasan Meta, Hamat Meta,** te pandehur ne procedimin penal ne gjykim, te akuzuar per kryerjen e veprave penale te parashikuara nga neni 186 dhe 287/1/dh te K.Penal.

Nga permbajtja e kesaj kontrate rezulton se shtetasit Hasan dhe Amat Meta kane vene ne dispozicion te Kerkuesit-subjektit ndertues seicili me nga 328,6 m2 truall per ndertimin e objektit 10-12 kate. Objekti do te ndertohej teresisht me investimin e ndertuesit dhe ne perfundim pronaret e truallit do te perfitonin nje pjese te siperfaqes ndertimore sipas percaktimit ne perqindje ne kete kontrate.

Konkretisht ne nenin 5 te kesaj kontrate eshte percaktuar:

***"NENI 5 TE DREJTATE PALEVE***

*-Ne perfundim te objektit te mesiperme midis paleve , do te krijohen marrdhenie e bashkepronese mbi truallin dhe objektet e ndertuara mbi kete ne raportet si me poshte :*

***-PALA PRONARE E TRUALLIT***

*-Pjesa e tyre mbi pasurine e perbashket truall dhe objekt do te jete 30% te siperfaqes ndertimore te ketij objekti .*

*Pronaret e truallit e vene truallin . ne dispozicion te shoqerise " Hanxhari" Sh p k . Vlore dhe shoqerise : " Breshani" sh p k te cilat pavaresisht nga perkatesia e prones, bene studimin e plote per te gjetur formen me te mire te ndertimit te objektit me tendencen per te rritur siperfaqen e ndertimit. Pala sipermarrese per nevoja te shpejtesise ne ne ndertim por duke mbajtur vete pergjegjesi personale mund te bashkepunoje edhe me ndonje shoqeri tjeter ndertuese duke lidhur kontrate bashkepunimi, si dhe te lidhi kontrata nenesipermarrje me subjekte te tjera per mbarevajtjen e punimeve.*

***PALA SIPERMARRESE , NJEKOHESISHTE EDHE INVESTITORE***

*-Pjesa e saj ne pasurine e perbashket truall dhe objekt i ndertuar mbi te do te jete 70 % te siperfaqes ndertimore te objektit se bashku me pjesen takuese te truallit . Pikerisht ne raport se sa me siper , palet pasi te kene studjuar me hollesi projektin e miratuar , do te vendosin te vecojne dhe caktojne pjeset e tyre takuese , duke respektuar raportin e sipershenuar .*

*-Ndarja dhe vecimi i pjese se secilit prej paleve ne kontrate , do te percaktoje brenda 30 diteve nga zbardhje e lejes se ndertimit dhe do te pasqyroje saktesisht ne aktin shtese e kontrates se sipermarrjes qe do te lidhet mes paleve . Shoqeria ndertuese njekohesishte investitore , merr persiper njoftimin e pales pronare te truallit brenda 10 diteve nga miratimi lejes se ndertimit te objektit Percaktimi i pjeseve takuese qe do te saktsohet ne aktin shtese dhe do te respektohet mes paleve ne kontrate deri ne fund te ndarjes ne natyre . Per sa i perket ndarjes ne natyre e siperfaqes se apartamentve dhe ambjenteve te sherbimit , pala pronare e truallit do te kete te drejten e parazgjedhjes per 50 % ( pesedhjete ) te siperfaqes qe asaj i perket nga siperfaqja totale e pjese se saj takuese , ndersa per diferencen caktimi do te behet nga pala sipermarrese , duke respektuar te drejtat e te dy paleve .*

*Ne raste se cdo diference e mundshme ne natyre si per siperfaqen e apartamenteve te banimit ashtu edhe per siperfaqet e amjneteve te sherbimit , konvertimi do te behet me lek apo Euro ne menyre te dyanshme ne baze te cmimit te shitblerjes qe do te percaktohet nga pala sipermarrese per te tretet."*

**Rezulton e provuar se Subjekti ndertues "Hanxhari" shpk,** me administrator Fatmir Hanxhari, ka lidhur **Kontrate Sipermarrje me Nr 3452 ,Nr 1084/4 kol, dt. 03/10/2011,** me shtetasit pronaret te truallit Eqrem dhe Meto Hoxha. Nga permbajtja e kesaj kontrate rezulton se shtetasit Eqrem dhe Meto Hoxha kane vene ne dispozicion te Kerkuesit-subjektit ndertues, truallin ne bshkapronesi prej 424 m2 dhe seicili me nga 92 m2 truall, gjithsejt 608 m2 truall, per ndertimin e objektit 10-12 kate, duke u bashkuar me truallin e kontraktuar me te pandehurit Hasan dhe Amat Meta. Objekti do te ndertohej teresisht me investimin e ndertuesit dhe ne perfundim pronaret e truallit do te perfitonin nje pjese te siperfaqes ndertimore sipas percaktimit ne perqindje ne kete kontrate.

**Mbi keto marreveshje,** eshte krijuar dokumentacioni mbi teresine e truallit te pronareve Eqrem dhe Meto Hoxha dhe Hasan dhe Amat Meta dhe eshte parashtruar kerkesa per dhenie shesh ndertimi prane KRT Vlore.

Rezulton e provuar se KRRT-ja e Bashkise Vlore me Vendimin me Nr.2/283, date 28.09.2011 ka miratuar destinacionin e sheshit te ndertimit dhe kondicioneve urbane te tij, per truallin ne pronesi te te pandehurve Hasan Meta, Amat Meta dhe Eqerem Hoxha dhe Meto Hoxha, per ndertimin e nje objekti polifunksional me 13 kate.

Me Vendimin me Nr.2/284 date 28.09.2011 te KRRT-se se Bashkise Vlore eshte miratuar leja e ndertimit ne favor te shoqerive "Hanxhari" sh.p.k dhe "Breshani" sh.p.k.

Ne rrethanat e pershkruara me siper, konkludohet se te pandehurit Amat Meta dhe Hasan Meta, duke lidhur kontraten e sipermarries me qellim per te perfituar 30 % te siperfaqes se objektit polifunksional qe eshte ne ndertim e siper, duke perdorur para noterit ne daten 03.10.2011 dokumenta per te cilat kane dijeni se permbajne rrethana te rreme, duke perdorur dhe investuar ne veprimtari ekonomike dhe financiare, pasurite e paluajtshme me nr.27/4/7 dhe 24/4/8 zona kadastrale nr.8602.

**Ne konkluzion te ketyre rrethanave Gjykata konkludon se te pandehurit Amat (Hamat) dhe Hasan Meta, kane perfituar pronesine mbi siperfaqet e truallit prej 328.6 m<sup>2</sup> truall, duke siguruar dhe perdorur dokumente te fallsifikuara dhe konkretisht:**

- **"Leje Meremetimi", nr. 124 i rregjistrimit te lejes date 12.06.1989, i perdorur nga i pandehuri Amat Meta per rregjistrimin e pasurise me nr.27/4/7, zona kadastrale nr.8602, volumi 28, faqe 77, me siperfaqe 328.6 m<sup>2</sup> truall,**
- **"Leje Meremetimi", nr.113 i rregjistrimit te lejes date 04.02.1989, i perdorur nga i pandehuri Hasan Meta per rregjistrimin e pasurise me nr.27/4/8, zona kadastrale nr.8602, volumi 28, faqe 78, me siperfaqe 328.6 m<sup>2</sup> truall.**

Me dokumentet e fallsifikuara te pandehurit kane rregjistruar pasurite ne Zyren VRPP Vlore, jane pajisur me Certifikata pronesie per keto pasuri dhe mbi kete baze kane realizuar kontraten e sipermarries me subjektin ndertues duke i vene ne dispozicion truallin e perfituar ne kete menyre, me qellim perfitimin e siperfaqeve ndertimore sipas kontrates.

Ne keto rrethana te pandehurit jane akuzohen se kane konsumuar secili elementet e vepres penale **"falsifikimi i dokumentave"**, me perdorim te tyre shume se nje here, te parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal, si dhe te vepres penale **"pastrimi i produkteve te vepres penale"** te parashikuar nga neni 287/1, pika (dh) te K.Penal, sipas permbajtjes se kesaj dispozite para ndryshimeve te bera me ligjin nr.23/ 2012.

V. – Ne fazen e hetimeve paraprake, me date 12/07/2013, mbi kerkesen e prokurorit, me vendimin nr.247, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore eshte vendosur sekuestro preventive mbi mbi objektin ne ndertim 10-12 kate, ne lagjen "Skele" te qytetit te Vlores, me pronar tualli te pandehurit Hasan Meta etj, dhe investitor "Hanxhari" sh.p.k., ne funksion te ceshtjes penale *ne ngarkim*

*te te pandehurve Hasan Meta dhe Amat Meta, te akuzuar per veprat penale te parashikuara nga nenet 186 dhe 287/d te K. Penal.*

Ne kete vendim eshte vendosur:

*“Pranimin e kerkeses.*

*Caktimin e mases se sigurimit te "Sekuestros preventive" te parashikuar nga neni 274 te Kodit te Procedures Penale, mbi pasurite si me poshte vijon:*

*- Objekti ne ndertim 10-12 kate, me nje kat nentoke, ne lagjen "Skele", Vlore, ne pronesine e Amat (Hamat) dhe Hasan Meta, mc investitor Hanxhari sh.p.k. Ngarkohet prokurori dhe policia gjyqesore per ekzekutimin e ketij vendimi...”*

Ky vendim eshte ekzekutuar, me venien e sekuestros mbi objektin ne ndertim. Efektet e vendimit te sekuestros jane shtrire edhe mbi te drejtat e pronesise te shtetasve Eqerem dhe Meto Hoxhaj dhe mbi investimin dhe aktivitetin e Shoqerise “Hanxhari” shpk, duke pezulluar punimet ne kete object. Qe nga dita e marrjes se vendimit per sekuestron dhe deri aktualisht, objekti eshte nen efektet e sekuestros preventive dhe subjekti ndertues “Hanxhari” shpk ka nderprere per shkak te sekuestros ndertimet ne object.

Gjate gjykimit te ceshtjes, mbi kerkesen e te interesuarit –kerkuesit “Hanxhari” shpk, Gjykata (kjo gjykate), me vendimin me nr.79, date 19.03.2014 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore eshte vendosur heqja e sekuestros preventive mbi te drejtat e pronesise se shtetasve Eqerem dhe Meto Hoxha mbi truallin e kontraktuar me Shoqerine ndertuese dhe mbi te drejtat e investimit te ligjshem dhe te aktivitetit te ligjshem te Shoqerise “Hanxhari” shpk, duke lene masen e sigurimit "**sekuestro preventive**" per truallin e te pandehurve, pasurite: Pasuria me nr.27/4/7, zona kadastrale nr.8602, volumi 28, faqe 77, me siperfaqe 328.6 m<sup>2</sup> truall, ne pronesi te te pandehurit Amat (Hamat) Meta; dhe Pasuria me nr.27/4/8, zona kadastrale nr.8602, volumi 28, faqe 78, me siperfaqe 328.6 m<sup>2</sup> truall, ne pronesi te te pandehurit Hasan Meta; si dhe per cdo te drejte qe do te perfitonin te pandehurit nga kontraktimi i ketyre pasurive me shoqerine ndertuese, sipas kontrates se siper marrjes.

Ky vendim i gjykates eshte ankimuar ne Gjykatën e Apelit dhe Gjykata, ne menyre verbale eshte vene ne dijeni se eshte prishur nga Gjykata e Apelit.

Ne keto rrethana rezulton nje gjendje juridike sipas se ciles ekziston ne fuqi masa e sigurimit pasuror te vendosur me Vendimin Nr 247, dt 12.07.2013 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore me te cilin eshte vendosur sekuestro preventive mbi mbi objektin ne ndertim 10-12 kate, ne lagjen "Skele" te qytetit te Vlores, me pronar tualli te pandehurit Hasan Meta etj, dhe investitor "Hanxhari" sh.p.k., ne funksion te ceshtjes penale *ne ngarkim te te*

*pandehurve Hasan Meta dhe Amat Meta, te akuzuar per veprat penale te parashikuara nga nenet 186 dhe 287/ d te K. Penal.*

Mbrojtja e te pandehurve ne gjykim, kundërshtoi akuzën ne ngarkim te te pandehurve duke kërkuar deklarimin te pafajshëm te tyre duke parashtruar se nuk provohet se dokumentet “leje Meremetimi” jane fallsifikuar nga te pandehurit, edhe nese ka ndodhur fallsifikimi, vete akuza parashtron se ka ndodhur ne 17.03.2007 dhe vepra penale “Fallsifikimi i dokumenteve” eshte parashtruar. Ne lidhje me veprën penale te “pastrami i produkteve te vepres penale “ mbrojtja pretendoi se nuk plotesohen elementet e kesaj vepre penale, perderisa sa nuk provohet fallsifikimi i kryer nga te pandehurit, nuk mund te akuzohen per nje veper te lidhur organikisht me te paren.

Rrethanat mesiperme u provuan ne gjykim me shqyrtimin ne teresine e akteve te veprimeve hetimore mbi gjykimin e shkurtuar te ceshtjes dhe vecanerisht:

Proces verbal per keqyrjen dhe marrjen e dokumentave date 04.07.2013, si dhe kopja e dokumentacionit bashkengjitur ketij proces verbali;

Proces verbal per sekuestrimin e dokumentave date 02.07.2013, te sekuestruara ne Z.Rr.P.P Vlore, si dhe dokumentacioni i sekuestruar bashkengjitur ketij proces verbali;

Proces verbal per sekuestrimin e dokumentave date 11.07.2013, te sekuestruara prane Bashkise Vlore, si dhe dokumentacioni bashkengjitur ketij proces verbali;

Shkresat me nr.193/6 prot date 15.07.2013, nr.193/7 prot date 15.07.2013, nr.193/8 prot dt. 15.07.2013, nr.193/9 prot dt.15.07.2013, nr.163/1 prot dt.25.06.2013, nr. 146/1 prot dt.10.03.2014, nr.114/6 prot dt.12.03.2014, te Arkivit Shteteror Vendor Vlore, si dhe dokumentacioni bashkengjitur;

Akt ekspertimi tekniko grafik me nr.2827, date 12.03.2014 i Drejtorise se Policise Shkencore, Tirane;

Aktet e tjera shkresore te ndodhura dhe te bashkengjitura ne fashikullin gjvqesor.

**Ne keto rrethana dhe mbi percaktimin e ligjit gjykata vlereson se:**

**Ne lidhje me akuzën per kryerjen e vepres penale te “Fallsifikimit te dokumeneteve” te parashikuar nga neni 186/2 te K.Penal:**

Neni 186 K.Penal parashikon: *“Fallsifikimi i dokumenteve  
Fallsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim  
deri në tre vjet dhe me gjobe nga dyqindmije deri ne gjashtëqind mije leke.  
Kur kjo veper kryhet ne bashkepunim ose me shume se nje here apo ka*

sjelle pasoja te renda, denohet me burgim nga gjashte muaj deri ne kater vjet.

*Kur fallsifikimi behet nga personi qe ka per detyre te leshoje dokumentin, denohet me .....*

**Gjykata vlereson** se per te patur konsumim te vepres penale te "Fallsifikimit te dokumenteve" duhet te rezultojne dhe provohen rrethana fakti te tilla qe te plotesojne konsumimin e elementeve te vepres penale te parashikuar nga neni 186 te K.Penal.

- **Object** I vepres penale te falsifikimit apo perdorimit te dokumenteve te fallsifikuara, te parashikuar ne nenin 186 te K.Penal, jane marredheniet juridike te vendosura per te siguruar mbrojtjen e veprimtarise se rregullt shteterore dhe private si dhe te mbrojtjes se interesave te ligjshme te shtetit dhe te shtetasve nga veprimet kriminale te fallsifikimit te dokumentave apo perdorimit te dokumenteve te fallsifikuara.  
Ne rastin konkret rezulton e provuar se te pandehurit kane perdorur seicili me vete nga nje document me permbajtje te rreme, document ne emer ten je institucioni shteteror, per te cilin kishin marre dijene me pare se nuk ekzistonte.
- Ne nenin 186 te K.P. "Fallsifikimi i dokumentave", parashikohet se **ana objektive** e konsumimit te vepres penale konsiston ne kryerjen e veprimeve aktive per fallsifikimin ose perdorimin e dokumentave te fallsifikuara. Nga ana objective veprimet per fallsifikimin e dokumentit konsistojne ne kryerjen e veprimeve per te ndryshuar permbajtjen e disponimeve te dokumentit perkunder rrethanave reale te disponimit. Ne paragrafin e dyte, nese veprimet e fallsifikimit apo te perdorimit te dokumentit te fallsifikuar kryhen ne bashkepunim, me shume se njehere apo ka sjelle pasoja te renda rendohet masa e denimit. Ndersa per shkak te rrezikshmerise se posaçme shoqerore, kryerja e vepres penale nga personi qe ka per detyre leshimin e dokumentit denohet me nje mase denimi me te rende, sikunder sanksionohet ne dispoziten e paragrafit te trete te nenit 186 te K.Penal.  
Ne rastin konkret rezulton e provuar se te pandehurit kane kerkuar informacion ne Arkivin Vendor, kane marre pergjigje negative per mungesen e dokumentit te kerkuar dhe me vone kane vene ne dore document me ekstrimetete te fallsifikuara, kane patur dijene per faktin e mosekzistences se ketij dokumenti dhe e kane perdorur ate per te regjistruar nje pronesi ne menyre te kundraligjshme. Rjedhimisht te pandehurit e kane konsumuar vepren duke perdorur nje document te ditur prej tyre se kishte qene i fallsifikuar.

Te pandehurit si **subject** te vepres penale jane madhore dhe plotesisht te pergjegjshem para ligjit.

- **Ana subjektive** e kryerjes se vepres penale te "Fallsifikimit te dokumentave" kerkon domosdoshmerisht ekzistencen e dashjes direkte. Ne kryerjen e kesaj vepre penale dashja direkte do te mund te evidentohet ne tre forma: *a)* dijenia e personit se ne permbajtjen e aktit po paraqet te dhena te rreme ose hartimi i nje akti te fallsifikuar; *b)* deshires per t'i kryer veprimet e mesiperme; *c)* kryerjen e veprimeve te fallsifikimit apo perdorimit me qellim fitimi apo ndonje interes tjetër personal.

Ne rastin konkret rezulton e provuar se te pandehurit kane siguruar nje document per te cilin kane patur dijeni per inekzistencen e tij dhe me permbajtje te rreme, me deshiren e tyre e kane perdorur kete document me qellim fitimin e pronesise mbi nje pasuri truall me qellim fitimin e kesaj pasurie.

*Ne keto rrethana Gjykata konkludon se te pandehurit Amat (Hamat) dhe Hasan Meta kane konsumuar teresisht elementet e vepres penale te "Fallsifikimit te dokumenteve" disa here dhe me pasoja te renda per pasurine shteterore, te parashikuar nga neni 186/2 te K.Penal dhe duhet te deklarohen fajtores per kryerjen e kesaj vepre.*

**Ne lidhje me akuzen per vepren penale te "Pastrim i produkteve te vepres penale" te parashikuar nga neni 287/1/dh te K.Penal (para ndryshimeve me Ligjin Nr 23/2012).**

Neni 287 K.Penal (para ndryshimit me Ligjin 23/2012) parashikon:

*"1.Pastrimi I produkteve te vepres penale I kryer nepermjet:*

*a) kembimit apo fshehjes se pasurise, me qellim fshehjen ose mbulimin e origjines se paligjshme te saj, duke ditur se kjo pasuri eshte product I vepres penale ose I veprimtarise kriminale;*

*b) fshehjes ose mbulimit te natyres se vertete, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronesise ose te drejtave ne lidhje me pasurine, duke ditur qe kjo pasuri eshte product I vepres penale ose I veprimtarise kriminale; ... ..*

*dh) perdorimit dhe investimit ne veprimtari ekonomike ose financiare te parave ose sendeve, qe jane produkte te vepres penale, denohen nga tre deri ne dhjete vjet .... .."*

Veprimet e te pandehurve kane patur per **object** dhe kane cenuar marredheniet juridike te vendosura nga shteti per te siguruar interesat shteterore dhe publike nga veprime te kundraligjshme te tjetersimit te pasurise se perfituar ne menyre kriminale dhe te mbrojtura posacerisht nga legjislacioni penal.

-nga **ana objective** te pandehurit kane kryer keto veprime ne menyre direkte duke patur dijeni, kane perdorur dokumentin me te dhena te rreme, kane perfituar nepermjet kryerjes se vepres penale te fallsifikimit siperfaqen e truallit, e kane tjetersuar ate me veprimet e kontraktimit per ndertim dhe

perfitimin e siperfaqeve te ndertimit nga nje subject investees, duke tjetersuar produktin (truallin) e perfituar nepermjet vepres penale te "fallsifikimit", ne siperfaqe ndertimore me qellim tjetersimin e tyre te metejsheem ne transaksione financiare.

-te pandehurit si **subject** te vepres penale jane madhore dhe plotesisht te pergjegjshem para ligjit.

-nga ana **subjective** te pandehurit keto veprime I kane kryer me dashje dhe me qellimin perfitimi pasuror.

*Ne keto rrethana gjykata konkludon se te pandehurit Amat (Hamat) Meta dhe Hasan Meta kane konsumuar teresisht elementet e vepres penale te "Pastrimi i produkteve të veprës penale", parashikuar nga neni 287/1 pika (dh) te K.Penal dhe duhet te deklarohen fajtores.*

- Ne lidhje me caktimin e denimit ndaj te pandehurve, Gjukata mban parasysh:

Neni 47 K.Pr.Penale percakton:

*"Gjukata cakton denimin duke respektuar dispozitat e pjeses se pergjithshme te ketij Kodi dhe kufijte e denimeve te parashikuar ne ligj per vepren penale.*

*Ne caktimin e denimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmerine e vepres penale, te autorit te saj, shkallen e fajit si dhe rrethanat lehtesuese dhe renduese".*

Ne zbatim te kesaj dispozite Gjukata mban parasysh ne caktimin e denimit per vepren penale te kryer nga i pandehuri, kufijte e denimit te parashikuar ne nenin 287/1 te K.Penal, rrezikshmerine e veprese penale dhe te autorit te saj, shkallen e fajit per nga mendimi criminal dhe veprimet e kryera, si dhe rrethanat lehtesuese dhe renduese, ne vecanti qendrimin e te pandehurit ndaj vepres penale te kryer dhe ndaj procedimit penal ndaj tij.

Nga ana tjeter, Gjukata vlereson se masa e denimit te te pandehurit nuk duhet te jete nje mase represive qe permbush vetem karakterin ndeshkues te denimit penal, por denimi i te pandehurit duhet te individualizohet duke patur parasysh personalitetin dhe rrethanat e kryerjes se vepres penale, si dhe duhet te jete ne perputhje me parimet e denimit penal. Caktimi i denimit per te pandehurin, por edhe ekzekutimi I tij, duhet te permbushet karakterin ndeshkues si dhe duhet ti sherbeje qellimit edukues dhe rehabilitues te te pandehurit.

Qëllimi i dënimit penal përveç ndëshkimit dhe rehabilitimit të autorit të veprës penale përqëndrohet dhe në *frenimin e posacëm dhe të përgjithshëm* në lidhje me kryerjen e veprave penale. Gjukata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit merr parasysh dhe efektin që do të ketë ky dënim si në sjelljen e mëvonshme të të pandehurit ashtu dhe në efektin parandalues të autorëve të krimeve në potencial.

Konkretisht Gjukata mban parasysh:



- Rrezikshmerine e larte te veprave penale me pasoja shoqerisht te rrezikshme dhe me tendencen e perhapjes se tyre.
- Rrezikshmerine shoqerore te te pandehurve.
- Rrethana te gjendjes familjare te te pandehurve, te gjendjes gjyqesore si te padenuar me pare, rrethana lehtesuese te parashikuara nga neni 49 K.Penal,
- Parashikimet e llojit dhe te masave te denimit ne nenet 186/2 dhe 287/1/dh (sipas gjendjes se dispozites para ndryshimeve me Ligjin Nr 23/2012) te K.Penal.
- Vleresimet dhe kerkimet e organit te akuzes.

Ne keto rrethana gjykata vlereson denimin e te pandehurve me burgim. Ne lidhje me masen e denimit me burgim gjykata vlereson se kerkimet e organit te akuzes jane ne perputhje me rrethanat e kryerjes se veprës penale, te rrezikshmerise se larte te veprave dhe te autoreve te tyre, rrethanat qe lidhen me gjendjen familjare dhe personalitetin e te pandehurit si dhe me rrethana te njejta te konsumimit te veprave penale nga seicili i pandehur.

Perfundimisht, gjykata konkludon denimin e seicilit te pandehur per veprat penale te parashikuara nga neni 186/2 dhe 287/1/dh te K.Penal perkatesisht me 2 (dy) dhe 6 (gjshte) vjet burgim, ne bashkim te denimeve me nga 7 (shtate) vjet burgim dhe ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.Penale urdherimin per zbritjen e 1/3 te mases se denimit ne ekzekutimin e vendimit.

**Ne lidhje me disponimin per provat materiale te sekuestruara gjate hetimeve paraprake dhe per masat e sigurimit pasuror, Gjykata vlereson:**

Neni 190 i K.Pr.Penale percakton:

*“Disponimi për provat materiale*

*1. Në vendimin përfundimtar ose në atë të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori caktojnë se çfarë duhet bërë me provat materiale duke urdhëruar:*

*a- sendet që kanë shërbyer ose ishin caktuar si mjet për kryerjen e veprës penale dhe sendet që përbëjnë përfitimin e nxjerrë nga ajo ose shpërblimin e dhënë a të premtuar për kryerjen e saj, merren dhe i kalojnë shtetit, përveç rastit kur këto sende janë të personave që nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale;*

*b- sendet, mbajtja ose qarkullimi i të cilave është i ndaluar, u dorëzohen enteve përkatëse ose zhduken;*

*c- sendet që nuk kanë asnjë vlerë zhduken;*

*ç- sendet e tjera u kthehen personave që u takojnë dhe, kur ka konflikt për pronësinë e tyre, ruhen gjersa ai të zgjidhet nga gjykata.*

*2. Provat materiale mund t'u kthehen personave që u përkasin edhe para mbarimit të procedimit, kur nuk dëmtohet zgjidhja e çështjes.”*

Mbi keto parashikime dhe ne rrethanat e provuara te ceshtjes Gjykata, ne perfundim te ketij shqyrtimi gjyqesor duhet te vendose kthimin e sendeve te sekuestruara pronareve te ligjshem dhe konfiskimin e atyre sendeve qe kane shqerbyer per kryerjen e vepres penale apo qe jane profukt i vepres penale. Kthimi apo konfiskimi duhet te behet mbi parashikimet e ligjit dhe konkretisht:

Neni 218 K.Pr.Penale percakton: *"1. Gjykata vendos kthimin e sendeve te sekuestruara kur nuk ka dyshim per perkatesine e tyre."...*

Neni 36 i K.Penal parashikon:

*"Neni 36 - Konfiskimi i mjeteve te kryerjes se veprës penale dhe produkteve te veprës penale*

*1. Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka te beje me marrjen dhe kalimin ne favor te shtetit:*

*a) te sendeve qe kane shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale;*

*b) te produkteve te veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore qe vërtetojnë tituj ose interesa te tjerë ne pasurinë qe rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;*

*c) te shpërblimeve, te dhëna ose te premtuara, për kryerjen e veprës penale;*

*ç) te çdo pasurie tjetër, vlera e se cilës i korrespondon asaj te produkteve te veprës penale;*

*d) te sendeve, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i te cilave përbejnë vepër penale, edhe kur nuk është dhënë vendim dënimi.*

*2. Nëse produktet e veprës penale janë transformuar ose shndërruar pjesërisht ose plotësisht ne pasuri te tjera, këto te fundit i nënshtrohen konfiskimit.*

*3. Nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri te fituara ne rruge te ligjshme, këto te fundit konfiskohen deri ne vlerën e produkteve te veprës penale.*

*4. Konfiskimit i nënshtrohen edhe te ardhurat ose përfitimet e tjera nga produktet e veprës penale, nga pasuritë ne te cilat janë transformuar ose shndërruar produktet e veprës penale ose nga pasuritë me te cilat janë përzier këto produkte, ne te njëjtën mase dhe mënyrë sikurse produktet e veprës penale."*

Rezultoi e provuar ne kete gjykim fajesia e te pandehurve Amat (Hamat) Meta dhe Hasan Meta per perfitimin e nje siperfaqe trualli prej 386 m2 per secilin, duke fallsifikuar dokumenta, rregjistrimi i pasurise eshte bere nga te pandehurit duke perdorur dokumentat e fallsifikuara dhe ne vazhdim pasurine e fituar nga vepra penale e fallsifikimit, si product te kesaj vepre penale, e kane kontraktuar me Kontrate Sipermarje me nje subject ndertues, duke perfituar ne perfundim te kontrates titujt e pronesise mbi siperfaqe ndertimore te percaktuara ne kete kontrate.

Rezultoni se gjate hetimeve paraprake eshte marre masa e sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" mbi truallin e perfituar nga te pandehurit, por edhe mbi pjesen tjeter te ndertimit ne pronesi te pronareve te ligjshem Meto Hoxha dhe ne teresi mbi truallin siperfaqe ndertimi, dhe objektin qe subjekti ndertues Shoqeria "Hanaxhari" shpk, me qellim vendosjen e sekuestron preventive jo vetem mbi pronesine e perfituar ne menyre te kundraligjshme nga te pandehurit, por per te ruajtur edhe titujt e pronesise te perfituar prej tyre me Kontraten e Siper marrjes.

Rezultoni se me date 12/07/2013, mbi kerkesen e prokurorit, me vendimin nr.247, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore eshte vendosur sekuestro preventive mbi objektin ne ndertim 10-12 kate, ne lagjen "Skele" te qytetit te Vlores, me pronar tualli te pandehurit Hasan Meta etj, dhe investitor "Hanxhari" sh.p.k., ne funksion te ceshtjes penale ne ngarkim te te pandehurve Hasan Meta dhe Amat Meta, te akuzuar per veprat penale te parashikuara nga nenet 186 dhe 287/ d te K. Penal.

Ne kete vendim eshte vendosur:

*"Pranimin e kerkeses.*

*Caktimin e mases se sigurimit te "Sekuestros preventive" te parashikuar nga neni 274 te Kodit te Procedures Penale, mbi pasurite si me poshte vijon:*

*- Objekti ne ndertim 10-12 kate, me nje kat nentoke, ne lagjen "Skele", Vlore, ne pronesine e Amat (Hamat) dhe Hasan Meta, mc investitor Hanxhari sh.p.k. Ngarkohet prokurori dhe policia gjyqesore per ekzekutimin e ketij vendimi ..."*

Ky vendim eshte ekzekutuar, me venien e sekuestros mbi teresine e truallit dhe mbi objektin ne ndertim e siper dhe qe nga dita e marrjes se vendimit per sekuestron dhe deri aktualisht, objekti eshte nen efektet e sekuestros preventive dhe subjekti ndertues "Hanxhari" shpk ka nderprere per shkak te sekuestros ndertimet ne object.

Gjykata vlereson se **Sekuestro Preventive**, si mase e sigurimit pasuror ka nje natyre krejt te ndryshme nga ajo konservative dhe mirret mbi sende qe, po te disponohen lirisht nga te pandehurit, 1-mund te rendojne apo zgjasin pasojat e vepres penale, 2- mund te lehtesojne kryerjen e veprave penale te tjera dhe 3- per sendet qe jane product te vepres penale dhe 4-per sendet qe lejohen te konfiskohen sipas nenit 36 te K.Penal.

Ky rregullim eshte parashikuar ne nenin 274 te K.Pr.Penale qe parashikon:

*"Objekti i sekuestros preventive. 1.- Kur ka rrezik qe disponimi i lire i nje sendi qe lidhet me vepren penale mund te rendoje ose te zgjase pasojat e saj ose te lehtesoje kryerjen e veprave penale te tjera, me kerkesen e prokurorit, gjykata kompetente urdheron sekuestrimin me vendim te arsyetuar.*

*2.Sekuestroja mund te vendoset edhe per sendet, produktet e vepres penale dhe cdo lloj pasurie tjeter qe lejohet te konfiskohet, sipas nenit 36 te K.Penal.*

*3. Kur ndryshojne kushtet e zbatimit, gjykata, me kerkesen e prokurorit ose te interesuarit, e heq sekuestron.”*

Vendimi Unifikues i Kolegjeve te Bashkuara Nr 1, dt 25.01.2007, ne trajtimin e caktimit te masave preventive qe lidhen me procedimet penale ndaj te akuzuarve per kryerjen e vepres penale te parashikuar nga nenit 287 te K.Penal – sic eshte edhe rasti konkret - ka orientuar unifikimin e praktikes gjyqesore me kete konkluzion:

*“Kolegjet e Bashkuara cmojne se, ..., meqenese venia ne perdorim e pasurive produkt i vepres penale (sipas nenit 287 te K.Penal) realizohet edhe me ane te shtimit, rritjes, transformimit, permiresimit, etj., mbi pasuri qe tashme jane ne disponim te ligjshem te personit te dyshuar, zbatimi i masave parandaluese pasurore duhet te kufizohet ne ato vlera te pasurise qe jane arritur si pasoje e venies ne perdorim te pasurise produkt i vepres penale, pra, vetem mbi ate pjese te pasurise qe rezulton te jete rezultat i rritjes ne menyre te pajustificuar ligjerisht te saj...”*

Ne analize te akuzes se ngritur dhe te provave te shqyrtuara ne gjykim, rezulton se te pandehurit akuzohen se kane kryer vepren penale te “Fallsifikimit te dokumentave” te parashikuar nga neni 186/2 te K.Penal, sipas akuzes te pandehurit pasi kane konsumuar fallsifikimin e dokumentave, me dokumenta te fallsifikuara kane perfituar ne menyre te kundraligjshme nje siperfaqe trualli, kjo siperfaqe eshte kontraktuar me te tretet –Shoqerine ndertuese per ndertimin e nje objekti nga i cili 30% e siperfaqes se ndertimit do tu kalonte ne pronesi te pandehurve.

Ajo qe provohet eshte se te pandehurit kane tjetersuar truallin, si product te drejperdrejte te vepres penale te “Fallsifikimit te dokumentave”, ne siperfaqe ndertimore nepermjet nje veprimtarie te ligjshme te kryer nga Shoqeria Ndertuese “Haxhari” shpk. Aktualisht sendi product i vepres penale –trualli i te pandehurve - eshte shderruar plotesisht si siperfaqe ndertimore dhe funksionale duke u bashkuar me siperfaqen e truallit te dy shtetasve te tjere, te nje objekti qe eshte ndertuar deri ne gjysmen e tij nga nje veprimtari e ligjshme.

Ajo qe duhet detyrimisht te konfiskohet sipas nenit 36 te K.Penal, jane produktet e vepres penale qe i jane bashkuar me pasuri te fituara ne rruge te ligjshme sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 36 te K.Penal: 3. Nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale.

Gjykata vlereson se konfiskimi i pasurise se te pandehurve dhe te pasurise se perfituar nepermjet saj duhet te konfiskohet duke u ndare nga pasuria e shtetasve te tjere qe e kane pronesine e truallit ne menyre te ligjshme sic rezulton ne rastin konkret te shtetasve Meto dhe Eqerem Hoxha si dhe nga aktiviteti i ligjshem i Shoqerise ndertues.

Ne perfundim te ketij gjykimi, me provat e shqyrtuara eshte identifikuar pasuria product i vepres penale te te pandehurve, pasuria dhe titujt e perfituar nepermjet saj nga te pandehurit dhe gjithashtu eshte identifikuar pronesia e ligjshme e shtetasve Meto dhe Eqerem Hoxha dhe veprimtaria e ligjshme e Shoqerise

Nderuese, ne rrethanat kur nuk rezulton ne ngarkim te tyre asnje akuze per veprimtarine qe lidhet me fitimin e pasurise te vene nen sekuestro me masen e marre.

Gjithashtu Gjykata ne perfundim te ketij gjykimi, ne zbatim te nenit 391te K.Pr.Penale duhet te disponoje edhe mbi dokumentet e fallsifikuara te provuara ne kete gjykim.

### PER KETO ARSYE

Ne baze te neneve 379 e vijues, 390, 406, 190, 275 dhe 391 te K.Pr.Penale si dhe nenit 36 te K.Penal.

### VENDOSI

- I – 1 Deklarimin fajtor te te pandehurit Amat (Hamat) Meta per kryerjen e vepres penale "*Falsifikimi i dokumentave*", me shume se nje here dhe me pasoja te renda, dhe ne baze te neneve 186/2 dhe 49 te K.Penal, denimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.
- 2- Deklarimin fajtor te te pandehurit Amat Meta per kryerjen e vepres penale "*Pastrimi i produkteve te vepres penale*" dhe ne baze te neneve 287/1, pika (dh) dhe 49 te K.Penal, sipas permbajtjes se saj para ndryshimeve te ligjit nr.23/2012 dhe denimin e tij me 6 (gjashte) vjet burgim.
- 3- Ne baze te nenit 55 te K.Penal, i pandehuri Amat (Hamat) Meta denohet perfundimisht me 7 (shtate) vjet burgim.
- 4- Ne baze te nenit 406 te K.Pr.Penale urdherohet zbritja e 1/3 e mases se denimit me burgim ne ekzekutimin e ketij vendimi.
- II –1 Deklarimin fajtor te te pandehurit Hasan Meta per kryerjen e vepres penale "*Falsifikimi i dokumentave*", me shume se nje here dhe me pasoja te renda dhe ne baze te neneve 186/2 dhe 49 te K.Penal, denimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.
- 2- Deklarimin fajtor te te pandehurit Hasan Meta per kryerjen e vepres penale "*Pastrimi i produkteve te vepres penale*" dhe ne baze te neneve 287/1, pika (dh) dhe 49 te K.Penal, sipas permbajtjes se saj para ndryshimeve te ligjit nr.23/2012 dhe denimin e tij me 6 (gjashte) vjet burgim.
- 3- Ne baze te nenit 55 te K.Penal, i pandehuri Hasan Meta denohet perfundimisht me 7 (shtate) vjet burgim.

4- Ne baze te nenit 406 te K.Pr.Penale urdherohet zbritja e 1/3 e mases se denimit me burgim ne ekzekutimin e ketij vendimi.

**III** - Ne baze te neneve 190 dhe 391/1 te K.Pr.Penale, deklarohen te falsifikuara dhe urdherohet fshirja e ekzistences se tyre nga cdo rregjister dhe zhdukja e tyre, per dokumentat e meposhtme;

- a- Shkrese nr.385/1 prot dt.25.10.2006 e Arkivit Shteteror Vendor Vlore;
- b- Leje meremetimi nr.124 date 12.06.1989, ne emer Hamat Meta;
- c- Shkrese nr.384/1 prot dt.25.10.2006 e Arkivit Shteteror Vendor Vlore;
- d- Leje meremetimi nr.1'13 date 04.02.1989, ne emer Hasan Meta;
- e- Certificate pronesie e pasurise nr.27/4/7, zona kadastrale nr.8602, ne emer te Hamat Meta, kartela e kesaj pasurie, harta treguese e rregjistrimit;
- f- Certificate pronesie e pasurise nr.27/4/8, zona kadastrale nr.8602, ne emer te Hasan Meta, kartela e kesaj pasurie, harta treguese e rregjistrimit;

**IV** - Ne baze te nenit 36/b te Kodit Penal dhe nenit 190 te K.Pr.Penale, te konfiskohen dhe te kalojne ne favor te shtetit, duke urdheruar fshirjen e pronesise ne emer te te pandehurve Amat (Hamat) Meta dhe Hasan Meta dhe rregjistrimin ne pronesi te shtetit ne Rregjistrin e Z.Rr.P.P Vlore, te produkteve te vepres penale "*falsifikimi i dokumentave*", te cilat jane nen masen e sigurimit te sekuestros preventive, dhe konkretisht;

- a. Pasuria me nr.27/4/7, zona kadastrale nr.8602, volumi 28, faqe 77, me sipërfaqe 328.6 m<sup>2</sup> truall, ne pronesi te te pandehurit Amat (Hamat) Meta;
- b. Pasuria me nr.27/4/8, zona kadastrale nr.8602, volumi 28, faqe 78, me sipërfaqe 328.6 m<sup>2</sup> truall, ne pronesi te te pandehurit Hasan Meta;

**V** - Ne baze te nenit 36/b te Kodit Penal dhe nenit 190 te K.Pr.Penale, **urdherohet konfiskimi dhe kalimi ne favor te shtetit, te produkteve te vepres penale**, te cilat jane nen masen e sigurimit te sekuestros preventive, mbi pjeset e objektit ne ndertim, ne teresine e objektit te perfunduar, te ndodhur ne Lagjen "Skele" Vlore, me investitor "Hanxhari" sh.p.k. me administrator Fatmir Hanxhari, me Vendim te K.RR.T. NR 2/283, dt

28.09.2011 "Per miratimin e sheshit te ndertimit..." te dhene shtetasve Meto Hoxha, Eqerem Hoxha, Hamat Meta, Hasan Meta, me Leje Ndertimi te dhene Subjektit Ndertues Shoqeria "Hanxhari" shpk me Vendimin e KRRT Nr 2/284, dt 28.09.2011, mbi siperfaqet e ndertimit (30% e siperfaqes se ndertuar ne cdo kat deri ne katin e dhjete) dhe mbi te gjithë titujt qe perfitojne te pandehurit Hasan Meta dhe Amat (Hamat) Meta, te kontraktuara me Kontrate Siper marrje Nr 3451 Rep, Nr 1083/2 Kol, dt 03.10.2011 te lidhur prane noteres Drita Aga, te lidhur midis shtetasve Hasan Meta dhe Amat (Hamat) Meta ne cilesine e pronarit te truallit prej 328,6 m2 seicili dhe paleve sipermarrese "Hanxhari shpk dhe "Breshani" shpk., dhe konkretisht;

- a. Garazhet ne katin (-2), dy cope, te shenuar ne projekt me nr.1 dhe nr.2;
- b. Garazhet ne katin (-1), 3 cope, te shenuar ne projekt me nr. 10, 11,14;
- c. Dyqani ne katin (1) me nr.10, me siperfaqe 43,8 m2 dhe dyqani ne katin (I) me nr.15, me siperfaqe 43.4 m2;
- d. Dyqani ne katin (2) me nr.8, me siperfaqe 38.1 m2 dhe nr.14, me siperfaqe 52.7 m2;
- e. Dyqan ne katin (3) te shenuar ne projekt me nr.14, me siperfaqe 100 m2;
- f. Apartamentet ne katin (4) te shenuar ne projekt me nr.5- siperfaqe 81.2 m2, nr.7-siperfaqe 81.2 m2, me nr.2-siperfaqe 125 m2;
- g. Apartament ne katin (5), te shenuar ne projekt me nr.2-siperfaqe 125 m2.
  
- j. Apartamentet ne katin (6) te shenuar ne projekt me nr.4-siperfaqe 81.2 m2, me nr.'10-siperfaqe 132.8 m2;
- k. Apartament ne katin (8), te shenuar me nr.3-siperfaqe 124.5 m2;
- l. Apartamentet ne katin (10), te shenuar me nr.3-siperfaqe 124.5 m2, me nr.6- siperfaqe 81.2 m2;
- m. Apartament ne katin (11), te shenuar me nr.6-siperfaqe 81.2 m2.

VI - Ne baze te nenit 190/1, germa (a dhe ç) te K.Pr.Penale, lidhur me dokumentet e tjera te sekuestruara, dokumentacioni i dosjeve te pasurive nr.27/4/7 dhe nr.27/4/7, zona kadastrale nr.8602, te pershkruar ne proces verbalin per sekuestrimin e dokumentave date 02.07.2013, ti kthehen Z.Rr.P.P

Vlore, sipas proces verbalit perkates te sekuestrimit. Cdo document tjeter original dhe i ligjshem, i sekuestruar ne kuader te ketij procedimi penal t'u kthehen personave qe u takojne.

VII – Ne baze te nenti 275/2 ne lidhje me nenin 190/1 germa urdherohet shuarja e efekteve te sekuestros preventive te vendosur mbi truallin ne pronesi te shtetasve Meto Hoxha dhe Eqerem Hoxha dhe mbi objektin ne ndertim nga Shoqeria "Haxhari" shpk., sipas ekstremiteve te dokumentacionit te pronesise dhe Lejes se ndertimit te cilesuara ne kete vendim.

-Shpenzimet proceduriale ne hetim, ne masen 51.000 leke, si dhe ato gjyqesore, t'ju ngarkohen proporcionalisht te pandehurve.

-Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Vlore brenda 10 diteve duke filluar nga e nesermja e shpalljes. (Per te pandehurit ne mungese afati fillon nga dita e komunikimit te ketij vendimi)

U shpall ne Vlore me 18.12.2014

GJYQTAR  
LAURENT FUÇIA

GJYQTARE  
ANASTASI SHEHU

GJYQTAR/kr  
ARQILE BASHO

Shpenzimet gjyqesore

Shpenzime proceduriale te hetimit _____	51.000 Leke
Shpenzime kancelarie _____	2.000 Lekë
Shpenzime totale _____	53.000 Lekë

Sekretare  
Luljeta KOLLOMBO



Vendimi mori formë të prerë me Vendimin Nr. 34 datë 26.01.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka vendosur :

- Lënien në fuqi të vendimit Nr. 633, datë 18.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Vlore më 03.03.2016

KANCELARE  
Rezarta TAUSHANI

